



Independent
Project
Accountability
Mechanism

Përmbledhja e Zgjidhjes së Problemit

Hekurudha Shqiptare
Projekti i BERZH-IT me Numër 48466
Çështja 2023/02

Tetor 2023

Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies së Projektit (IPAM) është mekanizmi i llogaridhënies së Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). IPAM-i shqyrton në mënyrë të pavarur çështjet e ngritura nga individë ose organizata në lidhje me projektet e financuara nga Banka, të cilat besohen se kanë shkaktuar dëm ose kanë gjasa të shkaktojnë dëm. Qëllimi i mekanizmit është të lehtësojë zgjidhjen e çështjeve sociale, mjedisore dhe publike të bërjes publike të informacionit ndërmjet palëve të interesit të projektit; të përcaktojë nëse Banka ka vepruar në përputhje me Politikën e saj Mjedisore dhe Sociale dhe dispozitat specifike të projektit të Politikës së Aksesit në Informacion; dhe, aty ku është e zbatueshme, të adresojë mospërputhjet e mundshme me këto politika, duke shmangur mospërputhjet e ardhshme nga ana e Bankës.

Për më shumë informacion lidhur me IPAM-in, kontaktoni ose vizitoni www.ebrd.com/project-finance/ipam.html

Informacione për kontaktin

Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies së Projektit
Banka Evropiane Për Rindërtim dhe Zhvillim
Rruga “Five Bank”
Londër E14 4BG

Numër Telefoni: +44 (0)20 7338 6000
Adresë Email-i: ipam@ebrd.com

Si t’ia dorëzoni ankesën tuaj IPAM-it

Shqetësimet lidhur me performancën mjedisore dhe sociale të një Projekti të BERZH- së mund të dorëzohen nëpërmjet Email-it ose nëpërmjet formularit online në:

 <https://www.ebrd.com/project-finance/ipam.html>

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE	4
1. KONTEKSTI.....	5
1.1. KËRKESA.....	5
1.2. Projekti Dhe Statusi i Tij Aktual.....	5
1.3. Përpunimi i Çështjes: Regjistrimi dhe Vlerësimi	6
2. INICIATIVA PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMIT	7
2.1. KONTEKSTI.....	7
2.2. Palët.....	7
2.3. OBJEKTI i Zgjidhjes së Problemit	8
2.4. Iniciativa e Zgjidhjes së Problemit: Projektimi dhe Rezultati.....	9
3. PËRFUNDIMET DHE HAPAT E MËTEJSHME	10
SHTOJCA 1. TERMAT E REFERENCËS PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMIT	11

Nëse nuk tregohet ndryshe, termat me germa kapitale të përdorura në këtë raport janë vendosur në Politikën e Llogaridhënies së Projektit 2019.

LISTA E SHKURTESAVE

Shkurtesa	Forma e gjatë
Bordi	Bordi i Drejtorëve të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
Çështja	konsiderimi i një Kërkesë sipas Politikës së Llogaridhënies së Projektit pas regjistrimit të tij
CAO	Krye oficeri i Llogaridhënies së BERZH-it, dhe kreu i IPAM-it
Regjistri i Çështjes	regjistri i Çështjeve krijuar në përputhje me Seksionin III, Paragrafin 3.1 të Politikës së Llogaridhënies së Projektit, i cili mund të gjendet në faqen e internetit të IPAM-it
Përputhja	funkcioni i IPAM-it përcakton nëse BERZH-i ka vepruar në përputhje me Politikën e saj Mjedisore dhe Sociale ose me dispozitat specifike të Projektit të Politika e Aksesit në Informacion në përputhje me Projektin
BERZH(ose Banka)	Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim
ESIA	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social
ESP	politika Mjedisore dhe Sociale e BERZH-it ishte në fuqi në kohën e miratimit të projektit
IPAM	Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies së Projektit të BERZH-it, i themeluar sipas Politikës së Llogaridhënies së Projektit në 2019
Kreu i IPAM-it	Drejtori menaxhues i BERZH-it, përgjegjës për drejtimin e IPAM-it, zbatimin e Politikës së Llogaridhënies së Projektit dhe marrjen e vendimeve të cilat bien nën përgjegjësinë e IPAM-it sipas Politikës
PAP	Politika e Llogaridhënies së Projektit në 2019
Palët	individët, njësitë, dhe/ose organizatat që kanë interes të drejtpërdrejtë në një Çështje. Palët mund të përfshijnë (por nuk janë të kufizuar te): Kërkuuesit; Përfaqësuesit, nëse ka të tillë; departamenti, ekipi ose njësia përkatëse e Bankës; Klienti; dhe Financuesit të tjerë të Projektit ose njësitë e tjera përgjegjëse për zbatimin e Projektit
Zgjidhja e Problemit	funkcioni i IPAM-it, i cili mbështet në mënyrë vullnetare zgjidhjen e mosmarrëveshjeve duke angazhuar Kërkuuesit dhe Klientët, në mënyrë që të zgjidhin çështjen mjedisore, sociale ose publike, të ngritur në Kërkesë, pa caktuar fajin apo gabimin.
PSD	Dokumenti i Përmbledhjes së Projektit
Presidenti	Presidenti i BERZH-it

1. KONTEKSTI

1.1. KËRKESA¹

Më 15 dhjetor 2022, [Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies së Projektit](#) (IPAM) mori një [Kërkesë](#) nga Z. Ditmir Zeqa, përfaqësues i 60 individëve (Kërkuesve), banues në komunitetin e Bërzhullës, në Bashkinë e Vorës, Shqipëri, lidhur me [Projektin e Hekurudhës Shqiptare](#) të financuar nga BERZH-i (OP ID 48466). Kërkuesit pretenduan se do të humbisnin aksesin te bizneset dhe banesat e tyre si dhe te xhamia vendase, sepse kalimi në nivel i hekurudhës që përdorin aktualisht do të mbyllej për shkak të projektit.


Edhe pse ishin në dijeni që projekti parashikonte një kalim automjetesh disa kilometra më larg, ky kalim konsiderohej shumë larg për kalimtarët, ndërsa lidhja me rrugët e tjera konsiderohej e papërshtatshme për automjetet e rënda. Ata shprehën interesin e tyre për shqyrtimin e Kërkesës sipas funksionit të Zgjidhjes së Problemit.

1.2. PROJEKTI DHE STATUSI I TIJ AKTUAL²

[Projekti i Hekurudhës Shqiptare](#) (OP ID 48466) është një hua prej 36.87 milion eurosh ndaj Republikës së Shqipërisë për t'u zbatuar nga Hekurudha Shqiptare (Klienti). Projekti ka për qëllim rehabilitimin e linjës ekzistuese hekurudhore me një gjatësi prej 34.17 km mes Tiranës dhe Durrësit dhe ndërtimin e një linje të re hekurudhore me një gjatësi rreth 5 km për të lidhur linjën ekzistuese hekurudhore Tiranë-Durrës me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës dhe zëvendësimin e linjës ekzistuese.

Projekti u miratua nga Bordi i BERZH-it më 30 nëntor 2016 dhe u klasifikua si Projekt i Kategorisë B, sipas Politikës Mjedisore dhe Sociale të vitit 2014 të Bankës. Sipas [Dokumentit të Përmbledhjes së projektit](#) (PSD), Projekti do të përfshinte çështje të ndryshme mjedisore dhe sociale, kryesisht për shkak të vendosjes së korridorit dhe mbylljes së një serë kalimesh, të cilat përdoren aktualisht nga komunitetet.

Linja Hekurudhore Tiranë – Durrës që do të rehabilitohet (vija e kuqe), lidhja e re me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (vija blu)



Burim: Kuadri i Marrjes në Pronësi të Tokës nga Projekti i Hekurudhës Shqiptare

¹ Kërkesa është e disponueshme në përmbledhje e çështjes në: [Çështje 2023/02](#)

² Informacioni është marrë nga Dokumenti i Përmbledhjes së Projektit të BERZH-it i disponueshëm [këtu](#) dhe Përmbledhja Jo-Teknike është e disponueshme [këtu](#)

1.3. PËRPUNIMI I ÇËSHTJES: REGJISTRIMI DHE VLERËSIMI

IPAM-it regjistroi Kërkesën më 6 shkurt 2023 sipas [Çështjes 2023/02](#) dhe nisi fazën e Vlerësimit. Si pjesë e kësaj faze, IPAM-i vizitoi vendndodhjen e Projektit në Shqipëri më prill 2023 (3-6 prill) dhe diskuto fizikisht me Hekurudhën Shqiptare, Kërkuesit, dhe ekipin e projektit të BERZH-it në Tiranë, për të kuptuar më mirë Projektin dhe çështjet e ngritura në Kërkesë. IPAM-i po ashtu u takua me kryetarin e Bashkisë së Vorës, Kreun e Njesisë Administrative të Bërzhullës dhe Imamin e xhamisë vendase.

Fotografi nga Vendndodhja e Projektit dhe takimet e IPAM-it, burimi: IPAM-i



Në këtë fazë, IPAM-i konfirmoi se Klienti kishte nisur punën për zgjedhjen teknike që do t'i ofronte aksesin komunitetit. Bazuar mbi këtë, të gjitha Palët konfirmuan interesin e tyre për t'u angazhuar në një proces të lehtësuar nga IPAM-i. [Raporti i Vlerësimit](#) i botuar më qershor 2023 përfshin Termat e Referencës për Zgjidhjen e Problemit, me anë të së cilës u prezantuan objekti, metodat dhe afatet kohore të propozuara si edhe llojet e ekspertizave të nevojshme. IPAM-i punësoi një lehtësues vendas nga Shqipëria për të punuar së bashku me ekipin e IPAM-it, që të mbështesë Palët gjatë zbatimit të zgjidhjes, derisa çështjet e ngritura në Kërkesë të adresohen plotësisht.

2. INICIATIVA PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMIT

2.1. KONTEKSTI

Funksioni i Zgjidhjes së Problemit nga IPAM-i mbështet dialogun mes Kërkuesve dhe Klientëve për të zgjidhur çështjet mjedisore, sociale dhe publike të ngritura në Kërkesë, pa caktuar fajin apo gabimet. IPAM-i angazhohet me Njerëzit e ndikuar nga Projekti, Klientët dhe palët e tjera të interesit si palë të treta neutrale, në mënyrë që të ndihmojë në gjetjen e zgjidhjeve të kënaqshme për të gjitha palët, nëpërmjet qasjeve fleksibël, të mbështetura në zgjidhjen e problemit me konsensus.

Në Çështjen 2023/02, 3 çështje kryesore që ishin kyç për Zgjidhjen e Problemit: 1. Klienti kishte nisur punën për zgjedhjen teknike që to të adresonte shqetësimet e ngritura nga Kërkuesi; 2. Afati kohor për finalizimin e projektit ishte mjaft i shkurtër dhe, 3. Zgjidhja kërkonte përfshirjen e Palëve të treta.

Politika e Llogaridhënies së Projektit 2019 paraqet kuadrin për hartimin e procesit, i cili do ti shkonte përshtat Çështjes. Më konkretisht, pohon se “IPAM-i do të marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e Çështjes (përfshirë natyrën e çështjeve të ngritura, emergjencën e tyre, si dhe mundësitë e arsyeshme për të pasur sukses), me një vështirësi për të identifikuar qasjen më të përshtatshme për Zgjidhjen e Problemit”³.

Po ashtu, PAP 2019 përcakton se qëllimi i Zgjidhjes së Problemit është: i. të lehtësojë dialogun midis Palëve; ii. të kërkojë për zgjidhje të pranueshme nga të gjitha Palët, të cilët zgjidhin çështjet e ngritura në Kërkesë; dhe; iii. të lehtësojë arritjen e marrëveshjeve mes Palëve.

Politika përcakton si Palë “individët, njësitë, dhe organizatat me interes të drejtpërdrejt në një Çështje. Palët mund të përfshijnë (por nuk janë të kufizuara te): Kërkuesit, përfaqësuesit e tyre, nëse ka të tillë: departamentin, ekipin ose njësinë e Bankës; Klientin; dhe financues të tjerë të Projektit ose njësi të tjera të përgjegjshme për zbatimin e Projektit”⁴.

Në mënyrë që procesi të ketë sukses, IPAM-it iu desh të përfshinte të gjithë palët e interesit, të cilët kishin interes në projekt dhe ishin të nevojshëm për të siguruar suksesin.

2.2. PALËT

Kërkuesit janë një grup prej 38 familjesh, 7 biznesesh të mëdha dhe besimtarëve nga një xhami vendase, të përfaqësuar në procesin e IPAM-it nga katër anëtar të komunitetit, të udhëhequr nga Ditmir Zeqa, Kërkuesi dhe Përfaqësuesi i përcaktuar nga komuniteti i tij.

Klienti: Hekurudha Shqiptare, operatori i sistemit të hekurudhës shqiptare është përgjegjës për infrastrukturën hekurudhore dhe operimin e trenave.

Aktorë të tjerë

Përveç Palëve kryesore, aktorët vijues janë me një rëndësi të veçantë për zgjidhjen efikase të shqetësimeve. Aktorët e tjerë morën pjesë në iniciativën e Zgjidhjes së Problemit, sipas sferës së përgjegjësisë të tyre dhe priten të luajnë rol kyç gjatë zbatimit të zgjidhjes për shqetësimet e ngritura.

Bashkia Vorë, ku banojnë/punojnë Kërkuesit, e përfaqësuar në Zgjidhjen e Problemit nga Zëvendësi i Kryetarit të Bashkisë.

Administratori i Njësisë Administrative Bërçull është përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të çështjeve të komunitetit dhe është pjesëmarrës në Zgjidhjen e Problemit.

³ Politika e Llogaridhënies së Projektit 2019, Seksioni 2.4, (b) I.

⁴ Politika e Llogaridhënies së Projektit 2019, Seksioni II: Përkufizime

Kontraktori është ngarkuar me rehabilitimin e seksionit të hekurudhës në fjalë dhe përfaqësuar në iniciativën e Zgjidhjes së Problemit nga Menaxheri i Projektit,

Mbikëqyrësi i Punimeve përfaqësuar nga Eksperti Social.

Menaxhimi i BERZH-it: edhe pse ekipi i BERZH-it nuk u konsiderua si një palë aktive në Zgjidhjen e Problemit, IPAM-i e konsideroi të rëndësishme angazhimin e vazhdueshëm ndërsa ekipi punonte me Klientin për të identifikuar zgjidhjen e shqetësimeve të ngritura dhe së bashku kishin siguruar fondet për zbatimin e saj. IPAM-i vijoi me zhvillimin e takimeve një herë në dy javë për të marrë informacion nga ekipi i Projektit, kërkoi mbështetjen e tyre për të siguruar përafrimin me objektin e projektit dhe planifikoi të vazhdojë angazhimin me ta gjatë fazës së monitorimit të Çështjes.

2.3. OBJEKTI I ZGJIDHJES SË PROBLEMIT

Sipas kushteve të vendosura në PAP 2019, Termat e Referencës të dakordësuar dhe të përcaktuar në kuadrin e Iniciativës së Zgjidhjes së Problemit, përcaktojnë metodologjinë që IPAM-i do të përdorë, si edhe burimet e nevojshme.

Përmbledhja e Termave të Referencës për Zgjidhjen e Problemit të Çështjes 2023/02

Objekti

Objekti i iniciativës do të përqendrohet në shërbimin e IPAM-it si palë e tretë, lehtësues i pavarur për të ndihmuar Palët gjatë periudhës së zbatimit të zgjidhjes së propozuar. Mekanizmi do të lehtësojë rrjedhën e informacionit dhe do të menaxhojë pritshmërinë e Palëve për të siguruar rezultate të suksesshme.

Metodologjia

Metodat e përdorura në këtë Çështje do të përfshijnë:

- Mbledhjen dhe ndarjen e informacionit në formate të përshtatshme sipas kulturës
- Ndërmjetësim
- Diskutime të përbashkëta dhe të lehtësuara me palët
- Mbështetje të negociatave

Përdorimi i Burimeve

- Punësimi i një lehtësuesi ekspert vendas për të bashkëpunuar me ekipin e IPAM-it në lehtësimin e Iniciativës së Zgjidhjes së Problemit
- Vizita në Vendndodhje: Iniciativa do të kërkojë vizita periodike nga ekipi i IPAM-it.
- Shërbime interpretimi

Temat: Iniciativa e Zgjidhjes së Problemit do të përqendrohet në sigurimin se zgjidhja teknike e propozuar nga Klienti do të adresojë nevojat e Kërkuesve lidhur me aksesin e kalimtarëve dhe automjeteve përgjatë pjesës së hekurudhës, që do të zëvendësojë kalimin në nivel që kanë përdorur deri më tani.

Po ashtu, iniciativa duhet të garantojë se kalimi në nivel do të qëndrojë i hapur deri në çastin kur zgjidhja teknike do të bëhet operacionale; dhe se punimet në ndërtimin e hekurudhës nuk do të pengohen nga komuniteti gjatë kësaj kohe.

Eksperti Lehtësues Vendas: Më qershor 2023, IPAM-i punësoi një ekspert lehtësues vendas, i cili flet rrjedhshëm shqipen dhe anglishten, për të bashkëpunuar me Drejtuesin e Zgjidhjes së Problemit të IPAM-it, nën mbikëqyrjen e Kreut të IPAM-it. Lehtësuesi është një specialist i trajnuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, me eksperiencë në angazhimin si pjesëmarrës me grupet e komunitetit dhe kompanive private. Lehtësuesi dygjuhësh ka njohuri të mira të kontekstit rajonal dhe të kulturës vendase ku operon Projekti.

2.4. INICIATIVA E ZGJIDHJES SË PROBLEMIT: PROJEKTIMI DHE REZULTATI

Në fillim të korrikut 2023, IPAM-i inicioi fazën e Zgjidhjes së Problemit duke angazhuar të gjithë Palët për t'i përgatitur për takimin e përbashkët.

Takimi i përbashkët u zhvillua më 23 korrik 2023 dhe kishte tri objektiva

1. Prezantimin e zgjidhjes teknike të Kërkuesit dhe përshtatjen e tij sipas kushteve
2. Dakordësimin e zgjidhjes dhe përkushtimin e pjesëmarrësve lidhur me sjelljen dhe afatet kohore
3. Nëse është e mundur, finalizimin e kushteve të marrëveshjes dhe nënshkrimin e saj.

Pas disa përshtatjeve të bëra për të adresuar nevojat e Kërkuesve, Palët dakordësuan kushtet e dokumentit dhe i kërkuan IPAM-it të jetë dëshmitar i nënshkrimit të Marrëveshjes. Kushtet e marrëveshjes mbeten konfidenciale.

Si pjesë e Marrëveshjes, u përcaktuan rregullat bazë dhe afatet kohore të monitorimit të IPAM-it.

Në këtë rast, kishte një zgjidhje lidhur me shqetësimet, afati kohor ishte shumë i shkurtër dhe Palët pjesëmarrëse kishin mundësi të vendosnin dhe të angazhoheshin. Kështu, Iniciativa e Zgjidhjes së Problemit u përqendrua në arritjen një Marrëveshjeje të hershme me fokus të veçantë në monitorimin e zbatimit të tij.

Fotografi nga nënshkrimi i Marrëveshjes midis Palëve, burimi: IPAM-i



3. PËRFUNDIMET DHE HAPAT E MËTEJSHME

Përmbledhja e Zgjidhjes së Problemit i është shpërndarë Palëve dhe është bërë publike në dokumentin virtual të [Çështjes 2023/02](#) në anglisht dhe shqip, pas dërgimit te bordi dhe Presidenti për informacion. Çështja është nën Monitorim për Marrëveshjen e Zgjidhjes së Problemit.

SHTOJCA 1. TERMAT E REFERENCËS PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMIT

I. Rreth procesit të Zgjidhjes së Problemit të IPAM-it

Politika e Llogaridhënies për Projektin në seksionin 2.4 përcakton udhëzimin e përgjithshëm që duhet ndjekur në nismat e Zgjidhjes së Problemeve të lehtësuara nga IPAM-i në përgjithësi:

Parimet udhëzuese për Zgjidhjen e Problemit

Nismat e Zgjidhjes së Problemeve nën drejtimin e IPAM-it mbështeten te parimet udhëzuese të mëposhtme:

Hartimi i përbashkët: hartimi i proceseve të Zgjidhjes së Problemeve duhet të bazohet te metodat, formati dhe preferencat e Palëve.

Mirëbesimi: suksesi i proceseve të Zgjidhjes së Problemeve kërkon që të gjitha Palët të jenë të gatshme të marrin pjesë në mirëbesim, duke synuar me efektivitet gjetjen e zgjidhjeve të pranueshme reciprokisht.

Mbështetja te rregullat: Proceset e Zgjidhjes së Problemeve kërkojnë që Palët të përcaktojnë që prej fillimit rregullat bazë që do të udhëheqin procesin dhe që marrin përsipër t'i respektojnë këto rregulla.

Natyra vullnetare: Palët kanë të drejtë të përfshihen, si dhe të tërhiqen nga një proces i Zgjidhjes së Problemit.

II. Objektivi

Objektivi i Zgjidhjes së Problemit është të:

- Lehtësojë dialogun ndërmjet Kërkuessve dhe Klientëve të BERZh-it (bashkërisht Palët), lidhur me zgjidhjen teknike të propozuar nga Klienti për të siguruar mirëkuptim të përbashkët dhe mbështetje për zbatimin e saj.
- Përcaktojë kërkesat sjellore bazë gjatë zbatimit të zgjidhjes për të siguruar garantimin e aksesit gjatë periudhës kohore që Klienti vijon me ndërtimin e segmentit hekurudhor sipas parimit të besimit dhe komunikimit.
- Formalizojë dakordimet e arritura dhe të shoqërojë zbatimin e tyre deri kur zgjidhja teknike të bëhet operacionale.

Për qëllimin e Zgjidhjes së Problemit, këta Terma Reference zbatohen për të gjitha veprimet e ndërmarra si pjesë e komponentëve të financuar nga BERZh-i të Projektit të Hekurudhës Shqiptare. Aktivitetet e kryera në kuadër të Termave të Referencës së Zgjidhjes së Problemit mund të pësojnë modifikime, me kusht që Kreu i IPAM-it të bjerë shprehimisht dakord për ndryshimin(et), dhe për sa kohë që këto ndryshime nuk cenojnë interesat e asnjërës Palë.

III. Qasja

IPAM-i shërben si një palë e tretë lehtësuese e pavarur që ofron udhëzime dhe synon të nxisë krijimin e besimit ndërmjet Palëve dhe të sigurojë angazhim të drejtë dhe të aksesueshëm.

Për të arritur objektivin e gjetjes së një zgjidhjeje të pranueshme reciprokisht për problematikat e parashtruara në Kërkesë, IPAM-i do të:

- marrë parasysh të gjitha rrethanat e Rastit (përfshirë edhe natyrën e çështjeve të ngritura, ngutshmërinë e tyre dhe mundësitë e arsyeshme për zgjidhje të suksesshme), me qëllim që të identifikojë qasjen më të përshtatshme të Zgjidhjes së Problemit. Qasjet zgjidhen në

konsultim me Palët dhe mund të përfshijnë: mbledhje dhe ndarje informacioni, diplomaci me ndërmjetësim, negociata të përbashkëta për gjetje faktesh ose mbështetje;

- ii. mosofrim mbështetjeje për marrëveshje që mund të bien ndesh me politikat e BERZh-it ose që janë në shkelje të ndonjë ligji në fuqi.

IV. Ndërprerja.

Procesi i Zgjidhjes së Problemit mund të ndërpritet kurdoherë:

- nga IPAM-i, nëse IPAM-i gjykon se, në vijim të konsultimeve me Palët, Zgjidhja e Problemit nuk mund të sjellë më rezultat pozitiv, dhe/ose nëse në procesin e Zgjidhjes së Problemit burimet nuk përdoren më me efikasitet, rast kur IPAM-i do t'i njoftojë të gjitha Palët me shkrim; ose
- nga secila Palë; Zgjidhja e Problemit është proces i vullnetshëm dhe Kërkuesit ose Klientët mund të tërhiqen kurdo.

V. Objekti i nismës

Objekti i nismës kufizohet të çështjet e parashtruara në Kërkesë lidhur me Projektin e BERZh-it dhe të shtjelluara më tej në Raportin e Vlerësimit. Në veçanti, Palët kanë rënë paraprakisht dakord që IPAM-i të shërbejë si një palë e tretë lehtësuese e pavarur për t'i asistuar Palët gjatë periudhës së zbatimit të zgjidhjes së propozuar. Roli i IPAM-it do të ishte ai i lehtësimit të shkëmbimit të informacionit dhe menaxhimit të pritshmërive të Palëve, për të siguruar një rezultat të suksesshëm.

VI. Metodologjia e propozuar

Mbështetur te gjetjet e Vlerësimit, dhe në varësi të konfirmimit gjatë ecures së nismës, metodat e përdorura në këtë Rast do të përfshijnë:

- Mbledhjen dhe ndarjen e informacionit në formate të përshtatshme kulturalisht
- Diplomacinë me ndërmjetësim
- Diskutimet e përbashkëta të lehtësuara ndërmjet palëve
- Negociatat me mbështetje

VII. Burimet e nevojshme

Lehtësuesi i Jashtëm i Pavarur

Në përputhje me parashikimet e PLIP-së së vitit 2019, procesi i Zgjidhjes së Problemit do të drejtohet nga Drejtuesi i Zgjidhjes së Problemit i IPAM-it, me mbështetjen e një lehtësuesi të jashtëm të pavarur nën mbikëqyrjen e Kreut të IPAM-it. Pritet që lehtësuesi të jetë një specialist i trajnuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të ketë një historik përfshirjeje pjesëmarrëse me grupet e komunitetit dhe kompanitë private. Lehtësuesi duhet të njohë mirë kontekstin rajonal dhe kulturën vendase të zonës ku Projekti operon.

Lehtësuesi duhet të flasë rrjedhshëm shqip dhe anglisht dhe të jetë një komunikues i shkëlqyer. Ai/ajo duhet të ketë përvojë të provuar në lehtësimin e mosmarrëveshjeve shumëpalëshe lidhur me projektet e zhvillimit. IPAM-i pret që lehtësuesi të ketë mundësi të udhëtojë në vendndodhjen e Projektit në Shqipëri dhe të ndërveprojë në mënyrë të konsiderueshme me Palët.

Lehtësuesi do të ndërveprojë me Palët si një 'palë e tretë' asnjansë, në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, dhe nuk duhet të ketë konflikt interesi lidhur me Projektin apo me ndonjë nga Palët e përfshira në Zgjidhjen e Problemit. Lehtësuesi nuk ka kompetencë të vendosë nëse veprimet, opinionet apo perceptimet e Palëve janë të drejta ose të gabuara apo të gjykojë në favor të njërës Palë.

Interpretimi dhe përkthimi

Për të lehtësuar komunikimin e IPAM-it me Palët vendase gjatë nismës, do të nevojiten shërbime interpretimi dhe përkthimi.

Vizitat në terren

Gjatë procesit do të nevojitet kryerja e vizitave në terren nga lehtësuesi i jashtëm dhe ekipi i IPAM-it. Çdo udhëtim do të kërkojë miratimin paraprak të Kreut të IPAM-it.

VIII. Afati i zgjidhjes së problemit

Më poshtë paraqitet një program kohor paraprak i etapave kryesore dhe produkteve, dhe mund të varet nga disponueshmëria e Palëve dhe faktorë të tjerë të jashtëm përtej kontrollit të IPAM-it.

Etapat dhe afati kohor i propozuar

Aktiviteti	Afati kohor i parashikuar
Ndërmarrja e nismës së Zgjidhjes së Problemit	Qershor 2023
Identifikimi i Përfaqësuesve, dakordimi i Zgjidhjes së Problemit; formati, aktivitetet e posaçme dhe afati kohor	Qershor 2023
Mbështetja e Palëve për arritjen e një marrëveshjeje mbi Zgjidhjen e Problemit, që përmban rregullat bazë për nismën dhe zgjidhjen e identifikuar	Korrik 2023
Monitorimi i Marrëveshjes së Zgjidhjes së Problemit dhe lehtësimi i shkëmbimit të informacionit ndërmjet Palëve	Gusht 2023 - Janar 2024
Angazhimi i vazhdueshëm me Palët për diskutimin e shqetësimeve që mund të lindin gjatë zbatimit të zgjidhjes së dakorduar.	Qershor 2023 - Janar 2024